



Tiranë, me 20.11.2013

I nderuar zoti Kryeministër,

Duke marrë shkas nga vendimi juaj dhe përfundimi në mënyrë të qytetëruar i protestave për të mos pranuar përpunimin në Shqipëri të helmeve të armëve kimike të Sirisë, lutemi të vlerësoni me të njejtën frymë qytetare situatën monstruoze të anarkisë së pronës zonës turistike Vlorë Sarandë.

Ju lutemi të veproni me përparësi për të realizuar miratimin e kërkesës tonë për t'i kthyer fizikisht pronarëve pronat e mohuara për 45 komunizëm dhe 23 vjet kleptokraci. Kjo kërkesë mbështetet në legjislacionin shqiptar të pas 1991 dhe më konkretisht në bazat ligjore të përmendura në vijim.

1. "Dispozitat Kryesore Kushtetuese" në 1991 e shfuqizuan kushtetutën komuniste të vitit 1976 dhe miratuan respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të konventave përgjithësisht të pranuar. Legjislacioni i pas 1991 pranon në princip njohjen dhe kthimin e pronës së trashëguar dhe kompensim kur ajo tjetërsohet për nevoja publike.
2. Ligji 7698/1993 në nenin 1, njeh të drejtën mbi pronën që na grabiti pa të drejtë sistemi i diktaturës që vendosi Enver Hoxha.
3. Ligji Nr.8053, datë 21.12.1995 në nenin 2/5 ju kthen tokat subjekteve të shpronësuar. Ky ligj i referohet "tokave bujqësore që (a.) janë pushtuar ose fituar në mënyrë të paligjshme, dhe (b.) kanë qenë në përdorim, por që nga përdoruesit janë bërë kalime pronësie të paligjshme ose çdo lloj veprimi tjetër të pabazuar në ligj". Në lidhje me to ligji thotë se veprimet për kalimin e pronësisë për rastet e përmendura në pikat "a" dhe "b", si dhe regjistrimet e këtyre kalimeve janë të pavlefshme.
4. Ligji 9235 lidhur me të drejtën e pronësisë sanksionon se „Çdo subjekt i shpronësuar ka te drejte te kërkojë, ne përpunim me këtë ligj, te drejtën e pronësisë, ne rast se i është hequr sipas akteve ligjore, nënligjore, vendimeve penale te gjykatave ose te marre me çdo mënyrë tjetër te padrejte nga shteti nga data 29.11.1944, si dhe kthimin ose kompensimin e pronës". Më tej në nenin 3, pika 2 ky ligj sanksionon se "Prona nënkupton një send te paluajjtshëm, sipas përcaktimit ne Kodin Civil" dhe në pikën 3 thotë se "Subjekt i shpronësuar nënkupton personat juridike ose fizike apo trashëgimtarët e tyre, pronat e të cilëve është shtetëzuar, shpronësuar, konfiskuar ose e marre me çdo mënyrë tjetër te padrejte nga shteti". Po aty në kreun II neni 6 , në pikë 1/b. ligji thotë se „U njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen subjekteve të shpronësuar, sipas kriterëve të këtij ligji, edhe pasuritë e paluajjtshme, toka me vendndodhje brenda territoreve turistike, sipas ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 "Për

zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", të ndryshuar". Këtë e ka përforcuar edhe neni 3 i ligjit nr. 57/2012.

Detyrimet kushtetuese dhe ligjet ka kohë që na e kanë dhënë të drejtën për të gëzuar pronën e trashëguar, por qeveritë qendrore dhe lokale, kryetarët e bashkive dhe prefektët e periudhës 1991-2013 na e kanë mohuar.

Vënia para përgjegjësisë e kryetarit të Bashkisë Vlorë Shpëtim Gjika për vetëm dy ndëtime, kur për të gjithë që kalojnë rrugës shohin se i gjithë bregdeti nga Uji i Ftohtë deri ne Sarandë është mbushur me ndëtime pa leje është betonuar dhe grabitur, duket si manovrim për të mbrojtur këtë abuzim dhe për të maskuar abuzimet ekstreme me transferimet e paligjëshme të pronave turistike, të bëra në vite nga kryetarët e bashkive prefektët dhe zyrtarë të tjerë.

Për sa më sipër ju kërkohet të vazhdoni pa dallime partiake punën e filluar për çlirimin e zonës turistike Vlorë-Sarandë nga ndërtimet që kanë bërë persona të tretë, të ngritura pa leje ose me leje ndërtimi jashtë kriterëve ligjore në pronat që konform Kushtetutës dhe ligjeve të cituara më sipër duhet t'ju kthehen pronarëve të trye .

Por për të mos ricikluar nëpër gjykata të gjithë pronarët e vërtetë, që ata do të mos bien pre e korrupsionit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për të bërë një zgjidhje të përgjithëshme konform kushtetutës, ju kërkohet të merrni vendim që kthimi i pronave në zonën turistike është detyrim të Shtetit, duke zbatuar në këtë zonë projektligjin e propozuar nga shoqata dhe të bërë publik në sitin e shoqatës www.defendingproperty.com siç ju kemi kërkuar edhe me letrën e datës 22.10.2013.

Në pritje të përgjigjes tuaj

Për kryesinë e Shoqatës "Bregdeti"

Me respekt

Dr. Niko Nesturi